



REPUBLIKA E MAQEDONIS SË VERIUT  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi dhe nenin 23 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) dhe nenit 40 dhe 41 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit nga parashtrues i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) në seancën e 50-të, të mbajtur me datë 21.07.2021 morri;

## VENDIM

Procedura sipas lëndës 12-3766 të vitit 2019, është formuar sipas denoncimit anonim me numër 12-3766 / 1 të datës 01.08.2019 e dorëzuar nga një grup vullnetarësh të interesuar, **NDËRPRITET**.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave, nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm të Komisionit shtetëror për parandalimin e korrupsionit në lëndën me numër 12-984/1 të vitit 2020.

Lënda me numër 12 -3766 e vitit 2020 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

## Arsyetim

Lënda me numër 12-3766 e vitit 2019 u formua me kërkesë nr. 12-3766 / 1 të datës 01.08.2019, dorëzuar në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit nga parashtrues i panjohur - grup vullnetarësh të interesuar.

Në denoncimin e dorëzuar janë nxjerr pohime kundër personave përgjegjës në personin juridik Kryqi i Kuq-Organizata Komunale -----dhe kërkohet fillimi i procedurave për shkak të keqpërdorimit të pozitës së tyre zyrtare dhe parregullsive në punë. I njëjti denoncim / kërkesë në kopje ishte dorëzuar dhe në Prokurorisë Publike të RMV-së dhe MPB-së të RMV-së Shkup.

Gjatë shqyrtimit të lëndës në fjalë, KSHPK i morri parasysh të gjitha pohimet e parashtruesit dhe me qëllim të përcaktimit të situatës së plotë faktike për këtë denoncim të parashtruar, KSHPK dorëzoi kërkesë për të dhëna dhe informacione autoriteteve dhe institucioneve kompetente. Pas kërkesave të Komisionit Shtetëror, janë dorëzuar njoftimet me informacionin e kërkuar me dokumentacionin e bashkangjitur dhe pas shqyrtimit dhe inspektimit të kryer në të gjithë dokumentacionin me të cilën disponon për lëndën në fjalë nga ana e KSHPK -së, u përcaktua situata e mëposhtme faktike:

- Në këtë rast bëhet fjalë për pohime dhe dyshime për shpërdorim të pozitës zyrtare nga Kryetari, Nënkyetari dhe Ushtruesi i Detyrës sekretari i Kryqit të Kuq-Organizata Komunale -----me qëllim

realizimin e fitimit financiar, nëpërmjet angazhimit të personave "vullnetarë", me të cilët u lidhën kontrata të dyshimta, për të cilat parashtruesit dyshojnë se u ishin paguar kompensim vullnetar të paligjshëm sepse u paguan më shumë se maksimumi ligjor, vullnetarët u punësuan nga njerëz që zakonisht ishin të afërm ose miq të ngushtë të tyre dhe që kështu fitonin para nga Kryqi i Kuq.

Në denoncimin e dorëzuar theksohen edhe parregullsi të tjera në punën e kësaj organizate komunale dhe keqpërdorimin e burimeve financiare të së njëjtës ( pagesa në bazë të udhëtimeve zyrtare që ishin përdorë për udhëtime personale, lidhjen e kontratave fiktive për angazhimin e personave në bazë të një kontrate për vepër me qëllim tërheqjen e parave nga llogaria e Kryqit të Kuq, punësim të personit të afërt në vendin e punës jurist përmes shpalljes për punësim që ishte rregulluar dhe zbatuar nga procedurat ligjore, pagesa e faturave fiktive për përfaqësim, etj.) , ndërsa për rastin ishin njoftuar institucionet dhe organet e tjera, si më poshtë: Shërbimi Qendror i Kryqit të Kuq të RMV-së, Inspektimi i Punës, Prokuroria Publike e RMV-së dhe MPB-së të RMV-së.

- Me datë 02.07.2020, me kërkesë të KSHPK-së, u dorëzua përgjigje nga Inspektorati Shtetëror i Punës duke informuar se rasti në fjalë ishte trajtuar nga Inspektorati Shtetëror i Punës PE ----- dhe se me datë 19.12.2019 iu kërkuar të dhëna nga Prokuroria Publike -----, pas së cilës u krye inspektim në subjektin juridik të parashtruar dhe ku parregullsitë si bazë për marrjen në dorëzim të masave, nuk ishin përcaktuar. Ishte dorëzuar kopje e Procesverbalit nga inspektimi i kryer me datë 10.01.2020 në Prokurorisë Themelore Publike -----.

Bazuar në situatën faktike të mësipërme të vërtetuar, për pohimet e parashtruara në lëndën e rastit vepruan organe të tjera që janë kompetente për të vepruar në sferën e lëndës dhe nuk u konstatua shkelje e ligjit, pas së cilës KSHPK vlerësoi se nuk ka elemente për veprim të mëtejshëm të saj në lëndën e rastit . procedura sipas lëndës ndërpritet dhe lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Duke pasur parasysh të theksuaren e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

KOMISIONI SHTETËROR  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT  
Kryetar,  
Biljana Ivanovska

Dorëzuar deri te: Arkivi  
Punoi: J.C.  
Miratoi: Mr.VG, anëtar i KSHPK-së

